

ABSTRAKTI

Për shkak të përparësive që sjellë negociimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë ka gjetur zbatim në shtetet bashkëkohore duke përfshirë edhe Kosovën, ku me ndryshim-plotësimet e bëra në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale, negociimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë, bëhet pjesë e legjislacionit në Kosovë në vitin 2008. Prandaj qëllimi i këtij hulumtimi është të analizoj legjislacionin kosovar përkitazi me negociimin për pranimin e fajësisë dhe ta krahasoj atë me legjislacionet e disa vendeve të rajonit. Poashtu do të analizohet edhe zbatimi i këtij instituti në praktikën e Gjykatës Themelore në Prishtinë gjatë periudhës kohore 2017-2022. Në këtë hulumtim është aplikuar metoda kualitative (deskriptive). Të dhënat janë mbledhur nga analizimi i legjislacionit për negociimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se dispozitat e përfshira në legjislacionin e Kosovës, Kodi nr.08/L-032 i Procedurës Penale ofrojnë bazë të mjaftueshme ligjore për zbatimin e negociimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë në praktikë, përkatësisht sipas nenit 230. Sa i përket krahasimit me legjislacionin e Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kroacisë rezultatet tregojnë se ka ngjashmëri, ndërsa dallimet vërehen kryesisht sa i përket peshës së veprave penale, afati kohor i negociimit, pëlqimi i viktimës për arritjen e marrëveshjes, i pandehuri si dëshmitar bashkëpunues. Sipas rezultateve të hulumtimit, në Gjykatën Themelore në Prishtinë ky institut është aplikuar në 361 raste penale, ku të gjitha marrëveshjet janë aprovuar nga gjykata. Këto marrëveshje janë arritur kryesisht për veprat penale; vjedhja e shërbimeve, lëndim i lehtë trupor dhe kanosja. Përkundër përparësive të kësaj mënyre të zgjidhjes së rasteve të veprave penale, negociimi i marrëveshjes së pranimi të fajësisë ende nuk zbatohet mjaftueshëm nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Fjalët kyçe: *prokurori, i pandehuri, marrëveshja për pranimin e fajësisë, legjislacioni, gjykata.*